




REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
AGENCIJA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep.	2-0/DPK	Nr. Prot.	01-310/15
Dep.		Br. Prot.	
Dep.		Prot No.	
Nr. I faq.		Data	06.02.2015
Broj stranica	02	Datum	
Nr. pages		Date	

PRISHTINE



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosova

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI – CORRUPTION AGENCY**

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 05.02.2015, mori:

V E N D I M

I. Mbylllet rasti me nr. AKK- 03 – 3969/14, për z. Agron Krasniqi – zv. Drejtor për Operacione në Fondin e Kursimeve Pensionale të Kosovës, për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për konflikt interesit në ushtrimin e funksionit publik, nr. AKK – 03-3969/14, për z. Agron Krasniqi – zv. Drejtor për Operacione në Fondin e Kursimeve Pensionale të Kosovës, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin Nr. 04/L-051 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Në këtë rast zyrtari i lartë z. Krasniqi, është hetuar për konflikt interesit në ushtrimin e funksionit publik, si zyrtar i lartë në Fondin e Kursimeve Pensionale të Kosovës dhe njëkohësisht pronar në biznesit privat “Cola - Com”, tanë me emërtimin “A&A TRADE”.

Fillimisht zyrtari i lartë është njoftuar me shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, për fillimin e procedurës së shqyrimit të gjendjes së konfliktit të interesit, ndërsa më pas është takuar me zyrtarët e Agjencisë për t'i sqaruar situatën në të cilën ndodhet dhe për ndryshimet që duhet të bëj, në mënyrë që të shmangë situatën e konfliktit të interesit.

z. Krasniqi është bindur për kufizimin si pronar në biznesin privat dhe ka pranuar rekomandimin e Agjencisë për ti bërë ndryshimet e nevojshme për të shmangur konfliktin e interesit.

Ndërkohe ka dërguar në Agjenci shkresën zyrtare, të lëshuar nga Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (DPKI 03 – 276/15), me të cilën vërtetohet se ka bërë ndryshimet e nevojshme. Me këtë kashmangur situatën e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Në pajtim me nenin 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korruptionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik;
- Drejtorit të DPK- së;
- Z./zpj. (zyrtarit përgjegjës).

Drejtor i Agjencisë kundër Korruptionit

Hasan Preteni

